



Projekti: Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare

Shkup, 19.04.2017

Tryeza e tretë e rumbullakët

„Ndikimi i likuidimit dhe fshirja sipas detyrës zyrtare të kontratave për punë – probleme në praktikë„

Në tryezën e tretë të rumbullakët, të organizuar më 19 prill 2017, në suaza të projektit „ Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare“, u diskutua mbi: „Ndikimin e likuidimit dhe fshirjes sipas detyrës zyrtare të kontratave për punë – probleme në praktikë„.

Përfaqësues të Ministrisë së ekonomisë, Agjencisë për punësim, Regjistrin Qendror dhe palë të tjera të interesit, diskutuan mbi mënyrën e rregullimit të statusit të të punësuarve në kushte kur dispozitat ekzistuese ligjore që rregullojnë procedurën e likuidimit, e në veçanti fshirjes së personave juridik nga regjistri tregtar sipas detyrës zyrtare, mospasjes së një përgjigjeje të plotë sa i përket kontratave për punë, pasojat juridike, si dhe mbi të drejtat e obligimet që fillojnë me ndërprerjen nga ana e punëdhënsit.



Në vend të procedimit të deritanishëm të rast pas rasti gjatë çajmërimit, në veçanti kur bëhet fjalë për firma të fshira, apo firma që janë në fshirje të sipër, me qëllim të definimit të datës dhe rrethanave të çajmërimit, është kërkuar përkufizimi i procedurës përmes së cilës do të rregulloheshin veprimi sipas detyrës zyrtare gjatë çajmërimit në Agjencinë për punësim, si de lidhjen e Regjistrat Qendror dhe koordinim me të cilin do të mundësohet kontroll më i mirë në firma për të cilat vijon afati për përcaktimin e statusit për kontroll në gjendjen e të punësuarve.

Gjegjësisht, as Ligji për marrëdhënie pune e as Ligji për shoqëri tregtare nuk i definojnë plotësisht pasojat juridike mbi kontratat e punësimit në rast të ndërprerjes së punëdhënësit, në pajtim me procedurën për fshirje të subjekteve sipas detyrës zyrtare. Edhe pse sipas Ligjit për evidencë nga sfera e punës, punëdhënësi është i detyruar të parashtrojë çajmërim për të punësuarin deri te APRM-ja, në afat prej 8 ditëve nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, e në praktikë ndodh që punëdhënësit ta kuptojnë pas disa muajve, ose të presin fshirjen që atëherë t'i çajmërojnë të punësuarit. Nëse punëdhënësi, pas përfundimit të marrëdhënies së punës, nuk e çajmëron të punësuarin në afatin e përcaktuar, çajmërimi nuk mund të bëhet edhe me kërkesë të të punësuarit, në bazë të procesverbalit të dorëzuar paraprakisht deri te APRM-ja nga inspektori i punës. Edhe pse rrallëherë, shembuj të tillë janë regjistruar në Agjencinë për punësim, si pasojë e çështjes së parregulluar me fshirjen e subjekteve sipas detyrës zyrtare.

Projekti „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare“ realizohet me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian ndërsa zbatohet nga ana e konsorciumit të udhëhequr nga Pohl Consulting & Associates, në partneritet me Ernst&Young.